

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS

BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT



Programi mësimor

Arsimi teknik dhe informatika për klasën IV

Shkup, 2021

TË DHËNA THEMELORE PËR PROGRAMIN MËSIMOR

Lënda mësimore	<i>Arsimi teknik dhe informatika</i>
Lloji/kategoria e lëndës mësimore	E obligueshme
Klasa	IV (e katërt)
Temat/fushat në programin mësimor	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Prezantim multimedial</i> • <i>Vizatimi teknik</i> • <i>Puna me materiale dhe dizajnimi</i> • <i>Kultura në trafik</i>
Numri i orëve	1 orë në javë /36 orë në vjet
Pajisja dhe mjetet	<ul style="list-style-type: none"> • Kompjuterë dhe projektor. • Vegla (gërshërë, bisturi), pajisje dhe materiale për punë (laps, gomë, vizore, trekëndësh, kompas, letër zmerile). • Mjete didaktike dhe vizuale: fotografi, slajde, modele, makete etj.
Normativi i kuadrit mësimor	Punën edukative-arsimore në klasën e katërt mund ta kryejë personi i cili është: <ul style="list-style-type: none"> • profesor/arsimtar/mësues i mësimit klasor, VII/1 ose VI/1 (sipas KMK) dhe 240 SETK; • pedagog i diplomuar, VII/1 ose VI/1 (sipas KMK) dhe 240 SETK.

LIDHSHMËRIA ME STANDARDET KOMBËTARE

Rezultatet nga të mësuarit të përmendura në programin mësimor shpijnë në përvetësimin e kompetencave të mëposhtme të përfshira nga fushat **Shkrim-leximit digjital** dhe **Teknika, teknologjia dhe sipërmarrësia** nga Standardet kombëtare:

<i>Nxënësi/nxënësja di dhe/ose është i aftë:</i>	
IV-A.1	t'i eksplorojë dhe krahasojë mundësitë e pajisjeve digjitale të njohura dhe të reja dhe individualisht të vlerësojë, zgjedhë dhe t'i përdore në mënyrë të pavarur ato që janë më të përshtatshme për një nevojë dhe situatë të veçantë;
IV-A.2	të vlerësojë kur dhe si është e nevojshme dhe efektive përdorimi i TIK për të zgjidhur një detyrë/problem, të zgjedhe dhe instaloje programe që i nevojiten, të përdore programe mbrojtjeje dhe të zgjidhe probleme rutinë në funksionimin e pajisjeve dhe rrjeteve digjitale;
IV-A.4	në bashkëpunim me të tjerët të analizojë një problem, të zhvillojë një ide dhe një plan për hulumtimin dhe zgjidhjen e tij dhe të planifikojë kur dhe për çfarë do të përdorë TIK;
IV-A.5	të përcaktojë se për çfarë informacioni ka nevojë, të gjejë, të zgjedhe dhe të shkarkojë të dhëna digjitale, informacion dhe përmbajtje dhe ta vlerësojë rëndësinë e tyre në lidhje me nevojën dhe besueshmërinë specifike të burimit;
IV-A.7	të zgjedhe dhe përdore mjetet e duhura TIK për komunikimit, ta ndajë me siguri informacionin, të kontaktojë dhe bashkëpunojë me të tjerët në projekte online, aktivitete sociale ose për përdorim personal;
IV-A.8	t'i përdore përmbajtjet digjitale, rrjetet arsimore dhe sociale dhe retë digjitale në mënyrë të sigurt dhe të përgjegjshme;
VII-A.4	të gjenerojë ide dhe të krijojë aktivitete që shpijnë në produkte dhe/ose shërbime;
VII-A.5	të inicojë projekte të thjeshta me vlerë kulturore, shoqërore ose tregtare, ta planifikojë zbatimin e tyre, duke marrë parasysh burimet e nevojshme dhe rreziqet e mundshme, dhe të shkruajë një raport mbi zbatimin;
VII-A.6	të zhvillojë një plan për prodhimin e një produkti me vlerë të përdorshme, për ta prodhuar produktin duke përdorur materiale, mjete dhe procedura të përshtatshme dhe për të kontrolluar funksionalitetin e tij;
VII-A.9	të marre pjesë aktive në punën ekipore sipas rregullave të miratuara më parë dhe me respekt të vazhdueshëm për rolin dhe kontributin e të gjithë anëtarëve të ekipit.
<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>	
IV-B.1	shkrim-leximi digjital është thelbësor për jetën e përditshme – e lehtëson mësimin, jetën dhe punën, kontribuon në zgjerimin e komunikimit, krijimtarisë dhe inovacionit, ofron mundësi të ndryshme për argëtim;
IV-B.2	përdorimi i papërgjegjshëm dhe i papërshtatshëm i TIK-ut ka kufizime dhe mund të bartë rreziqe për individin ose shoqërinë;
IV-B.3	potenciali i TIK do të rritet dhe duhet të monitorohet dhe përdoret, por gjithashtu që duhet të ketë një qëndrim kritik ndaj besueshmërisë, konfidencialitetit dhe ndikimit të të dhënave dhe informacionit të disponueshëm përmes pajisjeve digjitale;
IV-B.5	informacioni i disponueshëm në hapësirën digjitale duhet të përdoret në mënyrë etike, sipas rregullave të përcaktuara dhe për të mirën e njerëzve;

IV-B.7	përdorimi i tepërt dhe i papërshtatshëm (joergonomik) i teknologjive digjitale mund të ndikojë negativisht në shëndetin, jetën personale dhe sociale, dhe ruajtja joadekuate e mbeturinave digjitale ndikon negativisht mbi mjedisin;
VII-B.5	burimet nuk janë të pakufizuara dhe duhet të përdoren me përgjegjësi.

Programi mësimor gjithashtu përfshin edhe kompetencat përkatëse në fushat e: **Shkrim-leximit gjuhësor, Matematikë dhe shkencat natyrore dhe Zhvillim personal dhe social.**

<i>Nxënësi/nxënësja di dhe është i/e aftë:</i>	
I-A.10	ta kuptojë përmbajtjen e paraqitur vizualisht (diagramet, tabelat dhe grafikët, ilustrimet, animacionet, etj.), të jetë në gjendje të ndajë, analizojë, vlerësojë dhe përmbledhë përmbajtjen e paraqitur vizualisht dhe t'i shpjegojë ato (me shkrim dhe me gojë);
III-A.5	të rekomandojë/zbatojë shkallën në kontekste të ndryshme të jetës së përditshme;
V-A.4	të bëjë vlerësim të aftësive dhe arritjeve të veta (duke përfshirë pikat e forta dhe të dobëta) dhe mbi atë bazë të përcaktojë përparësitë që do të mundësojnë zhvillimin dhe përparimin e tij/saj;
V-A.11	të veprojë në mënyrë të pavarur, me vetëdije të plotë se kujt, kur dhe si mund t'i kërkojë ndihmë;
V-A.13	të komunikojë me të tjerët dhe ta prezantojë veten në mënyrë të përshtatshme për situatën;
V-A.15	të bashkëpunojë me të tjerët në arritjen e qëllimeve të përbashkëta, duke i ndarë pikëpamjet dhe nevojat e veta me të tjerët dhe duke marrë parasysh pikëpamjet dhe nevojat e të tjerëve;
V-A.17	të kërkojë informacion kthyes dhe mbështetje për veten, por gjithashtu të japë informacion kthyes dhe mbështetje konstruktive në dobi të të tjerëve;
V-A.19	të japë propozime, marrë parasysh mundësitë e ndryshme dhe t'i parashikojë pasojat në mënyrë që të nxjerre përfundime dhe të marrë vendime racionale;
V-A.21	ta analizojë, vlerësojë dhe përmirësojë të mësuarit e vet;
VI-A.3	t'i formulojë dhe argumentojë pikëpamjet e veta, t'i dëgjojë dhe analizojë pikëpamjet e njerëzve të tjerë dhe t'i trajtojë me respekt, edhe kur ata nuk pajtohen;
VI-A.11	t'i zbatojë rregullat dhe rregulloret për pjesëmarrje të sigurt në trafik.
<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>	
III-B.2	njohuritë nga matematika gjejnë aplikim në shumë fusha të jetës së përditshme;
III-B.3	njohuritë nga matematika janë të domosdoshme në përvetësimin e njohurive nga lëndët tjera dhe disiplinat shkencore;
III-B.8	çdo individ është përgjegjës për ruajtjen e mjedisit natyror në mjedisin e afërt dhe më gjerë dhe se ai duhet ta zhvillojë vetëdijen mjedisore dhe të veprojë drejt mbrojtjes dhe qëndrueshmërisë së mjedisit;
V-B.3	arritjet dhe mirëqenia personale në masë të madhe varen nga puna që ai/ajo investon dhe rezultatet që arrin;
V-B.7	iniciativa, këmbëngulja dhe përgjegjësia janë të rëndësishme për zbatimin e detyrave, arritjen e qëllimeve dhe tejkalimin e sfidave në situatat e përditshme;

V-B.8	ndërveprimi me të tjerët është i dyanshëm - ashtu si ai/ajo ka të drejtë t'i kërkojë të tjerëve që t'i mundësojnë atij/asaj të jetë i kënaqur me interesat dhe nevojat e tij/saj, ashtu edhe ai/ajo ka përgjegjësi t'u japë hapësirë të tjerëve për të kënaqur interesat dhe nevojat e tyre;
V-B.9	kërkimi i informacionit kthyes dhe pranimi i kritikës konstruktive shpijnë në përparim personal në nivel individual dhe social.

REZULTATET E MËSIMIT

TEMA: PREZANTIMI MULTIMEDIAL	
Numri i përgjithshëm i orëve: 8	
Rezultatet nga të mësuarit	
Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë të:	
1. përgatisë prezantim multimedial si mbështetje vizuale gjatë ekspozimit të një teme të caktuar dhe për prezantimin e gjetjeve nga hulumtimi.	
Përmbajtjet (dhe konceptet)	Standardet për vlerësim
<ul style="list-style-type: none"> Përgatitja e prezantimit multimedial (fonti, slajdi, dizajni i sllajdit, objekt grafik, animacion, tranzicion). 	<ul style="list-style-type: none"> E zgjedh programin për përgatitjen e prezantimit multimedial. E zgjedh dizajnin e slajdit. E zgjedh radhitjen e përshtatshme të elementeve në slajd. Shkruan tekst në slajd, duke përdorur fonte me stil të ndryshëm, ngjyrë dhe madhësi. Shton, llogaritë, kopjon dhe fshin slajde. Shton dhe redakton objekte grafike në slajd. Aplikon animacion në pjesë të slajdit. Aplikon tranzicion nga njëri slajd te tjetri. Përgatit prezantim në temë të caktuar ose në tema sipas zgjedhjes me përdorimin e elementeve dhe e ruan në kompjuter. E shfaq prezantimin në kompjuter (e kyç dhe i ndërron slajdet).
Shembuj për aktivitete	
<ul style="list-style-type: none"> Mësuesi demonstroi se si hapet një program adekuat për krijimin e prezantimit multimedial dhe si zgjidhet dizajni i slajdeve me radhitje të përshtatshme të elementeve. Nxënësit i përsëritin dhe i ushtrojnë procedurat të cilat i demonstroi mësuesi. Mësuesi demonstroi se si zgjidhet mbështetja adekuate gjuhësore (në gjuhën maqedonase, shqipe, turke, serbe, boshnjake dhe angleze) dhe si shkruhet teksti në slajdin ballinë. Nxënësit i përsëritin dhe i ushtrojnë procedurat të cilat i ka demonstruar mësuesi. Pastaj mësuesi demonstroi se si ndryshohet madhësia, ngjyra dhe stili i fontit dhe si ndryshohet pozicioni i tekstit në slajd. Nxënësit e ushtrojnë të njëjtën. 	

<ul style="list-style-type: none"> Mësuesi demontron se si hapet një slajd i ri, si të shkruhet tekst në slajd duke ndryshuar fontet dhe pozicionin e tekstit. Nxënësit e ushtrojnë të njëjtën gjë. Mësuesi pastaj demontron se si tekstet e gatshme dhe objektet grafike (ilustrime, grafikë, etj.) “importohen” në slajd, dhe nxënësit e përsërisin dhe ushtrojnë të njëjtën gjë. Mësuesi demontron se si importohet animacioni në slajd dhe si ndryshon tranzicioni i slajdit. Nxënësit e përsëritin të njëjtën gjë. Nxënësit tërheqin fleta me lëndët mësimore të shkruara (<i>Shkenca natyrore, Historia dhe shoqëria, Gjuhë angleze</i> etj.) në bazë të të cilave ndahen në grupe. Secili grup vendos në cilën temë të lëndës së tyre do të përgatisë një prezantim prej 8 deri në 10 slajde. Pastaj ata e përgatisin prezantimin, duke i aplikuar të gjitha elementët e mësuar. Kërkesa është që të jenë sa më kreativ dhe të aplikojnë sa më shumë variante të elementeve (fonte, madhësi, ngjyra, ilustrime, animacione, etj.). Prezantimet e përgatitura u prezantohen të gjithëve, dhe të gjithë anëtarët e grupit marrin pjesë në prezantim. 	
<p>Tema: VIZATIMI TEKNIK</p> <p>Numri i përgjithshëm i orëve: 8</p>	
<p>Rezultatet e mësimit</p> <p>Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë të:</p> <ol style="list-style-type: none"> interpretojë proporcion dhe kuota gjatë leximit të vizatimit teknik; përdor proporcion dhe kuota gjatë vizatimit të vizatimit teknik. 	
<p>Përmbajtjet (dhe konceptet)</p> <ul style="list-style-type: none"> Vizatimi teknik (pajisje për vizatim teknik: vizore, trekëndësh, këndmatës, kompas; lloje të vijave: vijë e hollë, bijë e plotë e trashë, vijë e ndërprerë, pikë-vizë-pikë) Kuptimi dhe proporcioni (kuota, vija të kuotave, numra të kuotave, shigjetë e kuotës, vijë ndihmëse e kuotës, proporcion në madhësi natyrore, proporcion për zvogëlim dhe zmadhim). Realizimi i skicës dhe vizatimi teknik i objekteve sipas ideve personale (skica dhe vizatimi teknik). 	<p>Standardet për vlerësim</p> <ul style="list-style-type: none"> Njeh dhe aplikon lloje të ndryshme të vijave teknike. Përdor pajisje për vizatimin e vijave horizontale, vertikale dhe diagonale. Kuoton vizatim të thjeshtë teknik me aplikimin e llojeve të përshtatshme të vijave teknike. E përcakton proporcionin në vizatim të dhënë. Vizatton dhe lexon vizatime teknike në proporcion. I sqaron karakteristikat e vizatimit teknik. Përpunon skicë dhe vizatim teknik me pajisjen për vizatim. Vizatton vizatim teknik me ndihmën e kompjuterit.
<p>Shembuj për aktivitete</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësit i identifikojnë dhe aplikojnë llojet e ndryshme të vijave teknike nga një vizatim i dhënë teknik, e pastaj vizatojnë lloje të vijave teknike me pajisjen për vizatim teknik. Nxënësit i identifikojnë elementet në një vizatim të dhënë teknik të trupave gjeometrik. Nxënësit e aplikojnë kuotimin në një vizatim të dhënë teknik të trupave gjeometrik. Nxënësit vizatojnë vizatime teknike të trupave gjeometrik me aplikimin e rregullave dhe teknikave për proporcion dhe kuotim. 	

- Nxënësit vizatojnë skicë dhe vizatim teknik të ndonjë objekti ose prodhimi (tryezë, karrige, dollap, klasë etj.).
- Nxënësit vizatojnë në vizatim të thjeshtë teknik në kompjuter me aplikimin e veglave nga programet aplikative (Majkrosoft word, Peint, EDU-robot).
- Nxënësit, të ndarë në grupe, realizojnë detyra projektuese me ndihmën e vizatimit teknik, rregullojnë dhoma me mobile, klasa, oborr shkolle etj.

Tema: **PUNA ME MATERIALE DHE DIZAJNIM**

Numri i përgjithshëm i orëve: **14**

Rezultatet e mësimi

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë të:

1. ndërton modele prej letre, kartoni dhe druri sipas vizatimit të dhënë;
2. harton, dizajnon dhe ndërton modele sipas idesë së tij prej letre, kartoni dhe druri.

Nxënësi/nxënësja do:

3. ta mbajë të rregulluar hapësirën për punë;
4. t'i përdorë materialet e punës në mënyrë racionale;
5. të praktikojë masa për mbrojtje gjatë punës me vegla dhe pajisjen për punë;
6. ta njej rëndësinë e ripërdorimit të materialeve.

Përmbajtjet (dhe konceptet)

Standardet e vlerësimit

- Puna me letër dhe karton (letër, karton, letër e ricikluar).

- I dallon cilësitë e letrës dhe kartonit.
- I përshkruan procedurat për përpunimin e letrës.
- Përpunon modele dhe makete prej letre dhe kartoni sipas vizatimit të dhënë.
- Përpunon modele dhe makete prej letre dhe kartoni sipas idesë së tyre.

- Puna me dru. Llojet, ndarja dhe përdorimi i drurit (dërrasa nga druri i butë).

- Përmend shembuj për aplikimin e gjysmë prodhimeve të drurit.
- I përshkruan procedurat të cilat aplikohen gjatë përpunimit të produkteve prej gjysmë prodhimeve të drurit në kushte shkollore.
- Përpunon modele prej gjysmë prodhimeve të drurit sipas vizatimit të dhënë.
- Përpunon modele prej gjysmë prodhimeve të drurit sipas idesë së tyre.

Shembuj për aktivitete:

- Nxënësve u prezantohen lloje të ndryshme të letrës dhe kartonit, ndërsa ata të ndarë në grupe më të vogla i identifikojnë dallimet dhe ngjashmëritë të vetive të veta dhe diskutojnë për mundësitë për riciklimin dhe për përdorimin e sendeve të bëra nga letra dhe kartoni.
- Nxënësve, të ndarë në grupe më të vogla, u jepen detyra që të hartojnë si duhet të organizohet hapësira e punës që të duket në rregull dhe të jetë e sigurt. Çdo grup e prezanton propozimin e vet, e kështu bashkarish i miratojnë rregullat për organizimin e klasës gjatë orës sipas arsimit teknik dhe për shfrytëzimin e materialeve dhe veglave që i kanë në dispozicion.
- Nxënësit i aplikojnë procedurat e punës: matja me vizore, trekëndësh, shënimi me laps, kompas, stilolaps i harxhuar, prerja me gërshërë, bisturi, ngjitja e letrës me ngjitës, bërja e vrimave me gërshërë.

<ul style="list-style-type: none"> • Duke përdorur letër dhe karton, nxënësit (në grupe, në çifte ose individualisht) dizajnojnë dhe ndërtojnë origami, labirint, pus, kornizë fotografie, mbajtëse telefoni, kuti dekorative, trupa gjeometrikë, model shtëpie, model aeroplani, mulli me erë, kartolina urimi, faqe shënues dhe sende të tjera. • Nxënësit njihen me produkte të ndryshme gjysmë të gatshme prej druri dhe i diskutojnë karakteristikat e tyre. Pastaj, të ndarë në grupe të vogla, ata hulumtojnë në internet mbi aplikimin e tyre (secili grup nga një produkt gjysmë të gatshëm), mbi mundësinë e ripërdorimit të materialeve dhe prezantimin e gjetjeve para të gjithëve. • Nxënësit i zbatojnë procedurat e punës: matje me vizore, trekëndësha, shënim me laps, kompas, prerje me gërshërë, bërje vrimash me gërshërë, bisturi, lëmim me letër zmerile, montim me ngjitës. • Duke përdorur letër, karton dhe elemente të drurit të butë, nxënësit (në grupe, në çifte, ose individualisht) dizajnojnë dhe ndërtojnë modele (për shembull, një model shtëpie, një varkë me vela, një aeroplan, një model urë, një automjet). • Nxënësit dizajnojnë, bëjnë modele dhe makete nga materiale të thjeshta, sipas idesë së tyre. 	
<p>Tema: KULTURA NË TRAFIK</p> <p>Numri i përgjithshëm i orëve: 6</p>	
<p>Rezultatet e mësimit</p> <p>Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë t'i:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. dallojë elementet bazë të rrugës dhe shenjave të trafikut për lëvizje të sigurt të këmbësorëve; 2. aplikojë rregullat për lëvizje të këmbësorëve, çiklistëve dhe trotineteve në trafik. 	
<p>Përmbajtjet (dhe konceptet)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Elementet bazë të rrugës në trafikun publik (rruga, shenjat e rrugës, trotuari, vendkalimi i këmbësorëve, ishulli i këmbësorëve, shtegu i këmbësorëve, shtegu i biçikletave). • Rregullat për lëvizjen e këmbësorëve, biçikletave dhe trotineteve në trafik (shenjat e trafikut për rrezikun, për urdhrat e lëshuara, për njoftimin, semaforin, policinë e trafikut, pajisjet e menaxhimit të biçikletave dhe trotineteve). 	<p>Standardet e vlerësimit</p> <ul style="list-style-type: none"> • I njeh elementet dhe objektet bazë në rrugë në trafikun publik. • I numëron llojet e shenjave të komunikacionit sipas formës dhe kuptimit. • I identifikon shenjat e trafikut për lëvizje të sigurt të këmbësorëve, biçikletave dhe trotineteve. • I përmend rregullat dhe rregulloret për lëvizjen e sigurt të këmbësorëve, biçikletave dhe trotineteve në trafik në situata të ndryshme. • Shpjegon se si rregullohet trafiku në kryqëzime.

Shembuj për aktivitete

- Nxënësit fotografojnë elementët e rrugës pranë shkollës, pastaj i prezantojnë në klasë dhe i mësojnë emrat e tyre. Përndryshe, prezantimet online përdoren për të identifikuar elementët e rrugës.
- Nxënësit marrin vizatime që tregojnë kryqëzime me semaforë, kryqëzime pa semaforë, rrugë me semaforë për këmbësorë, rrugë të pashënuara, rrugë me shtigje të biçikletave dhe rrugë pa shtigje të biçikletave. Detyra e tyre është të vizatojnë aty ku duhet të ketë një vendkalim për këmbësorë dhe/ose shteg biçikletash në secilën situatë dhe të shpjegojnë pse.
- Nxënësve u tregohen zgjidhje të ndryshme për kalimin e sigurt të rrugës për njerëzit në karrocë dhe njerëzit që janë të verbër. Më pas atyre u jepet detyra të përcaktojnë nëse kryqëzimet, trotualet dhe vendkalimet për këmbësorë pranë shkollës së tyre ofrojnë zgjidhje të tilla, dhe nëse nuk i ofrojnë ato, ata i shkruajnë një kërkesë komunës për t'i siguruar ato.
- Nxënësit luajnë një kuiz në të cilin mësuesi tregon kuptimin e një shenje të caktuar të trafikut dhe nxënësit përshkruajnë se si duket ajo shenjë (cila është ngjyra e saj, cila është forma e saj).
- Nxënësit vizatojnë shenja trafiku duke përdorur një kompjuter, duke përdorur aplikacionet e duhura.
- Nxënësit, të ndarë në grupe, bëjnë semaforë nga letra, karton dhe/ose dru të butë. Në oborrin e shkollës, ata vizatojnë lloje të ndryshme të kryqëzimeve dhe vendosin semaforët e bërë, kështu që ata shpjegojnë pse janë vendosur pikërisht atje.
- Nxënësit marrin ilustrime të situatave reale të trafikut që tregojnë respektimin dhe mosrespektimin e rregullave për lëvizjen e sigurt të këmbësorëve, biçikletave dhe trotineteve në trafik. Nxënësit i njohin situatat dhe diskutojnë pse një situatë është e sigurt dhe një tjetër jo.
- Nxënësit, të ndarë në grupe të vogla, shkruajnë në një fletë letre: 1) rregullat për sjelljen e këmbësorëve në trafik; 2) rregullat për sjelljen e biçikletave në trafik 3) pasojat e mosrespektimit të tyre për këmbësorët, çiklistët dhe pjesëmarrësit e tjerë në trafik dhe 4) kush është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave. Pastaj lexojnë atë që është shkruar para të tjerëve dhe së bashku përfundojnë për rëndësinë e respektimit të rregullave të trafikut.
- Nxënësit, të ndarë në grupe, kryejnë një simulim për kalimin e sigurt në kryqëzime në klasë ose oborrin e shkollës.

INKLUZIVITETI, BARAZIA/NDJESHMËRIA GJINORE, NDËRKULTURA DHE INTEGRIMI MES LËNDËVE

Mësuesi siguron inkluzivitet duke përfshirë të gjithë nxënësit në të gjitha aktivitetet gjatë orës së mësimi. Ai i mundëson secilit fëmijë të angazhohet në mënyrë njohëse dhe emocionale përmes përdorimit të qasjeve të përshtatshme (individualizimi, diferencimi, puna në grup, mbështetja e shokëve në klasë). Gjatë punës me nxënës me aftësi të kufizuara, aplikon një plan arsimor individual (me rezultate të përshtatura të të mësuarit dhe standarde vlerësimi) dhe, kur është e mundur, përdor mbështetje shtesë nga persona të tjerë (asistentë personal dhe arsimor, ndërmjetësues arsimor, tutorë vullnetarë dhe profesionistë nga shkollat e qendrave resurse). Monitoron të gjithë nxënësit rregullisht, veçanërisht ata nga grupet e cenueshme, në mënyrë që të jetë në gjendje të identifikojë vështirësitë e të mësuarit në kohën e duhur, për t'i inkurajuar dhe mbështetur ata në arritjen e rezultateve nga të mësuarit.

Gjatë realizimit të aktiviteteve, mësuesi i trajton njësoj si djemtë ashtu edhe vajzat, duke u kujdesur që të mos u caktojë role stereotipike gjinore. Kur formon grupe pune, ai përpqet të sigurojë ekuilibrin gjinor. Kur përzgjedh materiale shtesë në mësimdhënie, përdor ilustrime dhe shembuj që janë gjinorë dhe të ndjeshëm nga pikëpamja etnike/kulturore dhe inkurajojnë barazinë gjinore, d.m.th. promovojnë ndërkulturizmin.

Gjithmonë kur është e mundur, mësuesi përdor integrimin e temave/përmbajtjeve/koncepteve në planifikimin dhe zbatimin e mësimdhënies. Integrimi u mundëson nxënësve t'i përfshijnë perspektivat e lëndëve të tjera në atë që e mësojnë në këtë lëndë dhe t'i lidhin njohuritë nga fusha të ndryshme në një tërësi.

VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE

Për t'i mundësuar nxënësve të arrijnë standardet e pritshme të vlerësimit, mësuesi monitoron vazhdimisht aktivitetet e nxënësve gjatë mësimdhënies dhe të mësuarit dhe mbledh informacione për përparimin e secilit nxënës. Për pjesëmarrjen në aktivitete, nxënësit marrin informacion kthyes të cilat tregojnë nivelin e suksesit në realizimin e aktivitetit/detyrës dhe jepen udhëzime për përmirësim (vlerësim formues). Për këtë qëllim, mësuesi monitoron dhe vlerëson:

- përgjigjet me gojë ndaj pyetjeve të parashtruara nga mësuesi ose shoku i klasës,
- kontributi në realizimin e përfundimeve,
- përpunime praktike të ushtrimeve, detyrave (vizatim teknik, ilustrime, prezantime, modele, makete etj.) indirekt të lidhura me standardet,
- aktivitete hulumtuese gjatë të cilave nxënësi bën vëzhgim, parashikim, grumbullimin e të dhënave, prezantimi i rezultateve dhe prezantimi i tyre.

Pas përfundimit të mësimin të secilës temë, nxënësit marrin një notë përmbledhëse në formën e një përshkrimi të standardeve të arritura të vlerësimit. Vlerësimi përmbledhës rrjedh nga përparimi i bërë përmes teknikave të ndryshme të vlerësimit formues. Në fund të vitit shkollor, nxënësi merr një notë numerike.

Fillimi i zbatimit të programit mësimor	viti 2021/2022
Institucioni/përfaqëues i programit	Byroja e Zhvillimit të Arsimit
Në përputhje me nenin 30, paragrafi 3 nga Ligji për arsim fillor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 161/19 dhe 229/20) ministri i Arsimit dhe Shkencës e miratoi këtë program mësimor nga lënda e <i>Arsimit teknik dhe informatika</i> për klasën IV.	<p>nr. 08-7413/12 10.05.2021</p> <p style="text-align: right;">Ministrja e Arsimit dhe Shkencës, Milla Carovska, n.p.</p>